

V E N D I M
Nr. 573, datë 22.10.2001

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 83, DATË 26.2.2001 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE "PËR TARIFAT TELEFONIKE DHE PËR PAGESAT ELEKTRIKE NGA
PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000 "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të nenit 12 të ligjit nr.8098, datë 28.3.1996 "Për statusin e të verbërit", si dhe të nenit 38 të ligjit nr.8618, datë 14.6.2000 "Për telekomunikacionin në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Pika 3 e vendimit nr.83, datë 26.2.2001 të Këshillit të Ministrave ndryshohet si më poshtë vijon:

"3. Çdo përdorues me aftësi të kufizuara, që ka përfutur statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik ose statusin e të verbërit, paguan 20 për qind të vlerës së konsumit mujor të energjisë elektrike."

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare, dhe i shtrin efektet që nga data e hyrjes në fuqi të vendimit nr. 83, datë 26.2.2001 të Këshillit të Ministrave.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta